



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parshtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 72-të, të mbajtur më 29.07.2022, morri vendimin vijues:

### VENDIM

procedura ndaj lëndës me numër 09-7071/1 të datës 20.12.2021, e formuar sipas denoncimit të dorëzuar nga një parashtrues i njohur kundër personit zyrtarë -----drejtor në SHKF -----, -----, NDËRPRITET.

DKSK përcaktoi se pretendimet e denoncimit nuk konfirmohen, nuk është konstatuar shkelje të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, , pas të cilit KSHPK-ja nuk ka elemente për veprime të mëtejshme.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

### Arsyetim

Lënda me nr. 09-7071/1 të datës 20.12.2021 është formuar pas denoncimit të dorëzuar nga një parashtrues i njohur kundër personit -----drejtor në SHF -----, -----, me pretendime se drejtori e punësoi djalin e tijë në SHF-----, -----, në vendin e punës mësuesë i informatikës

Në drejtim të përcaktimit të gjendjes faktike në rastin konkret dhe përcaktimin e pretendimeve nga denoncimi, KSHPK kërkoi të dhëna dhe dokumentacione nga SHF -----.

Nga ana e drejtorit -----ishite dorëzuar dokumentacioni se në shkollë është punësuar djali i tijë në vendin e punës mësues i informatikës nëpërmjetë Shpalljes publike për punësim të datës 21.12.2011 me nr. 03-784/1. pas shpallje së realizuar, u miratua vendim për përzgjedhje më datë 13.01.2012 nga ana e drejtorit të tanishëm të SHF -----.

Përkatësisht, SHF -----, -----, e përfaqësuar nga drejtori -----, ka lidhur disa kontrata pune për një pozicion pune, mësues i informatikës me personin ----- me kohë të caktuar kohore dhe atë:

- Kontrata e punës me nr. 04-461/2 të datës 06.09.2011 për periudhën 06.09.2011 deri më 06.12.2011;

- Kontrata e punës me nr. 04-71/1 të datës 30.01.2012 për periudhën nga 01.02.2012 deri më 31.08.2012;
- Kontrata e punës me nr. 04-533/1 të datës 05.09.2012 për periudhën nga 01.09.2012 deri më 31.11.2012;
- Kontrata e punës me nr. 04-755/1 të datës 25.12.2012 për periudhën nga 01.02.2012 deri më 31.08.2012;
- Kontrata e punës me nr. 04-566/1 të datës 03.09.2013 për periudhën nga 01.09.2013 deri më 30.11.2013;
- Kontrata e punës me nr. 04-18/3 të datës 31.01.2014 për periudhën nga 01.02.2014 deri më 31.01.2014;
- Kontrata e punës me nr. 04-546/1 të datës 05.09.2014 për periudhën nga 01.09.2014 deri më 30.11.2014;
- Kontrata e punës me nr. 04-797/3 të datës 01.12.2014 për periudhën nga 01.12.2014 deri më 31.08.2015;

Më datë 04.03.2015 me nr. 03-132/1, drejtori ----- i SHF -----, ----- ka parashtruar kerkese ne komune ----- me listë – tabelë me pasqyrë të dhënash për punëmarrësit që plotësojnë kushtet ligjore për shndërrimin e marrëdhënies së punës nga ora fikse në atë të pacaktuar, ku ndodhet edhe personi -----.

Nga ana tjetër, personi zyrtar ----- u zgjodh drejtor i SHF -----, ----- me Vendimin nr. 08-1237/4 të datës 01.07.2015 të miratuar nga kryetari i komunës -----.

Në seancën e mbajtur më 29.07.2022, pas shqyrtimit të të gjitha pretendimeve, KSHPK, duke u nisur nga dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, arriti në përfundimin se procedura për përcaktimin e konfliktit të interesit kundër personit ----- të ndërpritet, drejtor në SHF-----, sepse pohimet nga denoncimidhe nuk janë konfirmuar dhe nuk është përcaktuar gjendje konflikti interesi.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËRORE  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
Nënkryetar,  
Nuri Bajrami

Pas përfundimit të seancës së KSHPK-së  
Përgatiti: K.Z., Udhëheqës